



Praktikat më të mira

Mësimi në vend të punës

Mandatuar nga:
Solidar Suisse Kosovo

Përgatitur nga:
ITED LLC - Institute for Training and Economic Development



Mësimi në Vend të Punës (MVP) Work Based Learning (WBL)

Mandatuar nga:
Solidar Suisse Kosovo

Përgatitur nga:
ITED L.L.C – Institute for Training
and Economic Development

Botuar nga:

Copyright © 2020 nga Solidar Suisse Kosovo dhe ITED L.L.C. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloj mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose ndryshe, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Mirënjohje dhe adresimet e hisedarëve të projektit ProSkills

Syzane Baja – Koordinatore e programeve, Solidar Suisse Kosovë

Projekti ProSkills

Duke u nisur nga fakti që burimi dhe potenciali thelbësorë i Kosovës konsiderohet të jetë rinia jonë, me ndryshimet në reformën në edukim dhe arsim janë krijuar mundësitë e fuqizimit ekonomik përmes krijimit të profesionistëve të rinj. Në këtë drejtim, Solidar Suisse në Kosovë ka iniciuar në vitin 2017 projektin ProSkills me qëllim të përmirësimit të qasjes së punësimit për të rinjtë e edukimit profesional falë shkathtësive relevante të marra nga program i mësimi në vend pune dhe bashkëpunimit në mes sektorit privat dhe atij të edukimit të mesëm profesional.

Besim Avdimetaj – Drejtor, Drejtoria e Arsimit Komunal (DKA), Pejë

Mësimi në vend pune

Rëndësia e mësimi në vend pune lidhet direkt me strategjinë për arsim dhe aftësim profesional si dhe me objektivat e Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017–2021. Objektivat e DKA-së lidhen ngushtë me ato të projektit ProSkills sa i përket AAP-së, gjë që ka ndikuar të kemi një bashkëpunim të ngushtë dhe shumë frytdhënës që nga viti 2017, e që do të vazhdon edhe më tutje. Mësimi në vend pune apo praktika profesionale është elementi thelbësor në gjithë procesin e adresimit dhe ngritjes së shkathtësive dhe aftësive profesionale të nxënësve. Me marrjen e këtyre aftësive dhe shkathtësive dhe kompetencave, nxënësit tanë e kanë më të lehtë punësimin e tyre në profesionet për të cilat aftësohen.

Burim Berisha – Pronar, kompania COM-ING, Pejë (kryetar i këshillit për AAP Pejë)

Roli i kompanive në AAP dhe MVP

Kompanitë kanë një rol të rëndësishëm në arritjen e shkathtësive për nxënësit e shkollave profesionale. Që nga viti 2017, kompanitë anëtare të Këshillit kanë arritur të trajnojnë më shumë se 200 të rinjë dhe mësimdhënës të këtyre shkollave. Një numër i caktuar ka arritur edhe të punësohen në kompanitë që kanë ndjekur trajnimet. Kompanitë kanë qenë shumë bashkëpunuese në zbatimin e projektit ProSkills, projekt ky që ka arritur të ndërtoj një urë bashkëpunimi afatgjatë në mes të sektorit publik (komuna dhe shkolla) me sektorin privat. Nga ky bashkëpunim, kompanitë anëtare janë shumë të kënaqura dhe me një gatishmëri të madhe presin edhe në ta ardhmen për të ofruar mësim në vend pune për të ndikuar në avancimin e tyre në shkathtësi dhe kompetenca.

Driton Berisha – Drejtor Ekzekutiv, Institute for Training and Economic Development – ITED L.L.C

Këshilli për Arsim dhe Aftësim profesional (AAP) Pejë

Në vitin 2017, ITED është angazhuar nga Solidar Suisse për të zbatuar projektin ProSkills në Pejë. Duke u nisur nga përvoja shumë vjeçare e ITED në Arsim dhe Aftësimin Profesional (AAP) në Kosovë, fillimisht ITED ka themeluar Këshillin për AAP në Pejë. Këshilli përbëhet nga 16 biznese, 3 shkolla profesionale, shoqatat e bizneseve, shoqëria civile, oda ekonomike, shoqatat e turizmit, si dhe përfaqësues nga komuna (DKA dhe DZHE). Qëllimi i Këshillit për AAP është promovimi i bashkëpunimit ndërmjet partnerëve në nivel lokal me qëllim që arsimi dhe aftësimi profesional të bazohet në nevojat dhe kërkesat që vijnë nga tregu. Këshilli vepron si organ këshillues i nivelit lokal i përbërë nga hisedarët kryesorë në mënyrë që të koordinojë dhe këshillojë institucionet përkatëse për arsim dhe aftësim profesional si dhe për trajnim në nivel lokal dhe qendror në lidhje me zhvillimin e plan programeve, të teknologjisë dhe të ndryshimeve të tregut si dhe nevojave të përgjithshme të tregut.

Arben Gjokolli – Drejtor

Shkolla e Mesme Teknike Profesionale “Shaban Spahija”, Pejë

Që nga fillimi i projektit “ProSkills” shkolla jonë ka qenë e kyçur aktivisht dhe ka përkrahur vazhdimisht zbatimin e projektit. Mësimi në Vend Pune (MVP), është një aktivitet që shkolla jonë e ka ndërmarr në vazhdimësi edhe në bazë të plan programeve mësimore. Gjithsesi, projekti ProSkills, është një projekt që ka ndihmuar shkollën në zgjerimin e bashkëpunimit me bizneset e ndryshme të sektorëve dhe drejtimeve që shkolla jonë ofron për nxënësit e rajonit të Pejës. Përveç MVP që tashmë është ngritur në nivelin shumë të avancuar ku kemi mbi 150 nxënës dhe rreth 25 mësimdhënës që kanë ndjekur MVP në më shumë se 30 biznese, që nga viti 2019 projekti ProSkills ka ndihmuar shkollën edhe në themelin e Qendrës së Karrierës në shkollën tonë. Kjo Qendër tashmë funksionon ngushtë me projektin dhe është bazë e mirë për të marr përsipër disa aktivitete të projektit ProSkills në të ardhmen.

Arif Ademaj – Drejtor

Shkolla e Mesme Ekonomike Profesionale “Ali Hadri”, Pejë

Shkolla jonë ofron drejtime të ndryshme që lidhen direkt me kërkesat nga tregu i punës. Që nga viti 2017 shkolla jonë ka qenë përkrahëse e vazhdueshme e projektit ProSkills. Për disa drejtime, MVP shkolla e jonë e realizon me kompanitë e ndryshme në rajonin e Pejës, por gjithashtu edhe në laboratorët shkollorë. Por me ndihmën e projektit ProSkills, ne deri më tani ne kemi arritur të bashkëpunojmë me shumë kompani që lidhen me profilet që shkolla jonë ofron. Që nga viti 2017, me ndihmën e projektit ProSkills, ne kemi arritur të realizojmë MVP me rreth 30 nxënës dhe 10 mësimdhënës.

Shkurtesat

MVP	-	Mësimi në Vend të Punës
PP	-	Praktika Profesionale
AAP	-	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
IAAP	-	Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional
BE	-	Bashkimi Evropian
EYE	-	Rritja e Punësimit të të Rinjve
MKRS	-	Ministra e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MASHT	-	Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	-	Ministra e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	-	Organizatë joqeveritare
ZeP	-	Zyra e Punësimit
SDC	-	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
TpT	-	Trajnim për trajner
UNDP	-	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
USAID	-	Agjencia e SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar
QAP	-	Qendra e Aftësimit Profesional
DKA	-	Drejtoria e Arsimit Komunal
DZHE	-	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Përmbajtja

Hyrje	6
Mësimi në Vend të Punës (MVP)/ Work Based Learning (WBL) apo Praktika Profesionale	6
Qëllimi i Manualit	9
Kushtet për zbatimin e programit MVP	9
Hisedarët kyç në suksesin e programit MVP	10
Kriteret e përzgjedhjes së nxënësve	10
Kriteret e përzgjedhjes së kompanive	12
Standardet e sjelljes në MVP	12
Plani Hyrës në MVP	14
Plani Mbikëqyrës	15
Vlerësimi i MVP	16
Përfitimet e Shkollës	16
Roli i Shkollës	17
Përfitimet e Bizneseve	20
Rolet e Bizneseve	21
Rolet dhe përfitimet e nxënësve	26
Plani i rezultateve mësimore në MVP	27
Roli dhe përfitimet e prindërve	27
Siguria e nxënësve në MVP	29
Kompensimi në MVP	29
Sigurimi Aksidental në MVP	30
Rastet e Suksesit për Profilet	32
Organizimi i MVP se Praktikës Profesionale në Kompani	36
Organizimi i MVP se Praktikës Profesionale në Punëtoritë në Shkollë	36
Lista e dokumenteve dhe mjeteve të përdorura për MVP nga ProSkills	39
Format që janë përdorur nga projekti ProSkills	41
Falenderime	58

HYRJE

Mësimi në Vend të Punës (MVP)/ Work Based Learning (WBL) apo Praktika Profesionale

Mësimi në vendin e punës, me tutje i referohemi – MVP, është një formë e arsimit dhe aftësimit profesional, me tutje i referohemi – AAP, kualifikimit profesional, i cili organizohet në partneritet mes punëdhënësve dhe institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional me tutje i referohemi – IAAP.

Sipas Kornizës së re të Kurrikulumit të Kosovës (KKK), programet e praktikës profesionale janë pjesë e kurrikulumit të shkollave të mesme AAP, që janë të bazuara në rezultate të arsimit dhe nxënies së bazuar në kompetenca dhe paraqesin kornizën si vijon:

Klasa	Teori %	Praktikë %
10	60%	40%
11	50%	50%
12	40%	60%

Praktika Profesionale është një formë e mësimit përmes përfshirjes praktike me botën e punës. Ne këtu përdorim termin që nënkupton mundësitë e ofruara për nxënësit e shkollave profesionale të mesme në Kosovë për të kaluar periudha të shkurtra kohore duke punuar në biznese reale (dhe në organizata tjera) për tu ndihmuar atyre që të krijojnë lidhje me njohuritë teorike me mësim praktik për të zhvilluar disa nga shkathtësitë praktike që do ju duhen atyre për të hyrë në punë. Ekziston një fushë e gjerë për të zhvilluar këtë lloj përvojë pune në Kosovë por për të vepruar kështu do të duhej një zgjerim në numrin e bizneseve (dhe organizatave tjera) të cilat dëshirojnë të ofrojnë mundësi të tilla.

Çka në fakt do të BËJNË nxënësit gjatë praktikës së tyre profesionale varet nga specializimi i tyre profesional, mosha e tyre, përvoja dhe aftësia por gjithashtu varet edhe në atë se çka ofron kompania. Disa shembuj në lidhje me llojet e aktiviteteve të cilat mund të përfshihen në Praktikën Profesionale janë:

- ★ Ndihma e ofruar punëtorëve të rregullt gjatë punës së tyre;
- ★ Kryerje e detyrave të punës së përshtatshme nën mbikëqyrje;
- ★ “Vrojtimi” i punëtorëve me përvojë dhe vëzhgimi i tyre gjatë punës së tyre;
- ★ Kryerja e projekteve të vogla për kompaninë;
- ★ Kryerje e hulumtimeve, studimeve apo analizave të një shkalle të ulët;
- ★ Përpilimi i raporteve teknike të thjeshta;
- ★ Në baza periodike, mësimdhënësi i praktikës do të monitorojë nxënësit praktikant në ndërmarrje;
- ★ Ndihma për të dizajnuar materiale marketingu siç janë posterët, tabelat, grafikët etj.



Qëllimi i Manualit Proskills & ITED

Ky doracak paraqet praktikat më mira të përkrahura nga projekti ProSkills i zbatuar nga ITED dhe përkrahur nga Solidar Suisse.

QËLLIMI I MANUALIT


Qëllimi i këtij doracaku është që të udhëzoj shkollat profesionale, nxënësit, bizneset si dhe IAAP-të me zhvillimin e MVP, si dhe paraqet praktikat më të mira që janë zhvilluar në komunën e Pejës, përkatësisht shkollës së mesme teknike profesionale “Shaban Spahija” si dhe shkollës së mesme ekonomike profesionale “Ali Hadri”.

Ky doracak paraqet praktikat më mira të përkrahura nga projekti ProSkills i zbatuar nga ITED dhe përkrahur nga Solidar Suisse.

Këto praktika gjejnë zbatim në profilet e caktuara që kanë qenë të identifikuar dhe zbatuar nga projekti ProSkills, e kjo duke u bazuar edhe nga kërkesat dhe tregu i punës me aprovimin e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional (KAAP) në Pejë.

KUSHTET PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT MVP

Për zbatimin e suksesshëm të programit MVP nevojiten disa parakushte, të cilat do ti listojmë në bazë të përvojës së projektit ProSkills 2017–2020.



HISEDARËT KYÇ NË SUKSESIN E PROGRAMIT MVP

Me qëllim të arritjes së objektivave, Arsimi dhe Aftësimi Profesional duhet të bazohet në katër shtyllat kryesore:

1. Shkolla Profesionale
2. Nxënësi
3. Biznesi
4. Institucionet Arsimore (qëndrore dhe lokale)



KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NXËNËSVE

Edhe pse praktika profesionale apo MVP duhet të përfshijë të gjithë nxënësit e shkollës së mesme profesionale, shkolla duhet të njoftoj dhe përgatisë nxënësit për të vijuar MVP, sipas këtyre pikave:

- ★ Të ketë sjellje të mira
- ★ Të ketë komunikim të duhur
- ★ Sukses mesatar në mësim
- ★ Përparësi nxënësit që kanë në vizion punësimin pas përfundimit të shkollës së mesme
- ★ Saktësia dhe respektimi i orarit të punës;
- ★ Mësimi dhe respektimi i rregullave gjatë praktikës profesionale;
- ★ Tregimi i respektit për punëtorët dhe pronarët e kompanisë;
- ★ Bashkëpunimi me punëdhënësin dhe zbatimi i të gjitha kërkesave të arsyeshme;
- ★ Zbatimi i procedurave të sigurisë dhe sjellja konform me to në mënyrë që të mos rrezikohet shëndeti dhe siguria e tyre dhe të tjerëve.
- ★ Sjellje sipas standardeve më të larta dhe respektim maksimal i rregullave të punës në ndërmarrje;



Kriteret e përzgjedhjes së kompanive

Bizneset në komuna duhet të shihen dhe janë partner vendimtarë në zbatimin e praktikës profesionale apo MVP.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KOMPANIVE

Bizneset në komuna duhet të shihen dhe janë partner vendimtarë në zbatimin e praktikës profesionale apo MVP. Shkollat duhet të identifikojnë bizneset që plotësojnë së paku këto kriteret para se të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi dhe dërgimin e nxënësve në vijim të PP apo MVP. Kriteret që duhet të plotësohen nga bizneset janë:

- ★ Të jetë biznes i regjistruar pranë autoriteteve përkatëse
- ★ Të ketë të shlyera të gjitha obligimet tatimore – para marrëveshjes së praktikës profesionale apo MVP
- ★ Të jetë biznes që përmbush sigurinë gjatë praktikës profesionale apo MVP
- ★ Të ketë orar të përshtatshëm
- ★ Të ketë kushtet e punës
- ★ Gjatë MVP apo praktikës profesionale të caktohet një mentor për nxënës gjatë praktikës

STANDARDET E SJELLJES NË MVP

Shkollat do ti informojnë nxënësit e tyre para se ata të fillojnë praktikën e tyre profesionale në lidhje me standardet e sjelljes dhe se çka pritet nga ata/ato në vendin e punës. Ky informim do të ndryshoj varësisht nga lloji i profesionit dhe kompania por normalisht do të përfshijë kërkesat e përgjithshme siç janë:

- ★ Saktësia dhe respektimi i orarit të punës;
- ★ Mësimi dhe respektimi i rregullave të punëtorisë;
- ★ Tregimi i respektit për punëtorët dhe pronarët e kompanisë;
- ★ Bashkëpunimi me punëdhënësin dhe zbatimi i të gjitha kërkesave të arsyeshme;
- ★ Zbatimi i procedurave të sigurisë dhe sjellja konform me to në mënyrë që të mos rrezikohet shëndeti dhe siguria e tyre dhe të tjerëve.
- ★ Sjellje sipas standardeve më të larta dhe respektim maksimal i rregullave të punës në ndërmarrje;



Plani Hyrës në MVP apo Praktika Profesionale

Është e rëndësishme të planifikoni se si do ti prezantoni informacionet bazë, të cilat nxënësit kanë nevojë ti dinë.

PLANI HYRËS NË MVP

Nxënësit me siguri nuk do të kenë njohuri për aktivitetet, ambientin dhe objektivat e kompanisë apo organizatës suaj dhe prandaj është e rëndësishme të planifikoni se si do ti prezantoni informacionet bazë, të cilat nxënësit kanë nevojë ti dinë. Edhe pse nxënësit mund ti kenë disa njohuri se si operon institucioni/biznesi, atyre mund të ju mungoj përvoja e çështjeve të tilla siç janë nevoja për konfidencë, rëndësia e punës ekipore apo nevoja e kompanisë për të kontrolluar shpenzimet dhe për të krijuar profit.

Sa më shpejtë që nxënësit e kuptojnë se çka bën organizata juaj dhe se si operon aq më shpejtë ata mund të bëhen më mbështetës dhe ndoshta mund të ju caktohen përgjegjësi dhe të bëhen më produktiv. Ju mund ta ndihmoni këtë proces duke menduar për disa çështje kryesore paraprakisht. Ne sugjerojmë që ju të siguroheni se:

- ★ Personat kyç janë të informuar për arritjen e nxënësve kështu që ata të jenë të mirëseardhur në kompani dhe tu prezantohen punëtorët relevant;
- ★ Nxënësit janë të informuar në lidhje me ndërtesën dhe asetet e kompanisë;
- ★ Nxënësit kanë informata të përgjithshme në lidhje me produktet/shërbimet, klientët e kompanisë etj.
- ★ Nxënësit janë të informuar në lidhje me orarin e punës, rregullat dhe rregulloret e kompanisë, kodin e mirësjelljes dhe kodin e veshjes së kompanisë (në rast nevojë);
- ★ Nxënësit takojnë mentorin e tyre në kompani menjëherë;
- ★ Nxënësit janë të informuar në lidhje me ndonjë rrezik potencial dhe në lidhje me masat e sigurisë së kompanisë;
- ★ Nxënësit janë të informuar në lidhje me kujdesin ndaj konsumatorëve dhe në lidhje me sjelljen e duhur ndaj konsumatorëve të kompanisë;
- ★ Nxënësit janë të informuar për ndonjë “bën dhe s’bën” tjetër.

Për të gjitha këto, profesori i praktikës profesionale, duhet të përgatisë planin e praktikës profesionale para çdo praktike në bazë të plan programit shkollor dhe objektivave të mësimi.

PLANI MBIKËQYRËS

Suksesi i praktikës profesionale varet nga aranzhimet dhe marrëveshjet midis kompanisë, shkollës dhe nxënësit. Prandaj është me rëndësi që të caktohet një mbikëqyrës i cili mund të veproj si lidhje kryesore midis të tri palëve dhe i cili do të duhet të jetë i aftë të ofroj udhëzime dhe reagime për nxënësit. Ngjashëm nëse shfaqet ndonjë problem ata duhet të jenë në gjendje të këshillojnë nxënësin dhe të kontaktojnë shkollën në rast nevojë.

Një plan mbikëqyrës është shumë i rëndësishëm për nxënësin gjithashtu dhe kompania duhet të jetë përgjegjëse për mbikëqyrje të vazhdueshme të nxënësit gjatë qëndrimit të tij në kompani. Nxënësit të cilët vijojnë praktikën profesionale duhet të kenë një mbikëqyrës të zotuar për zhvillimin e tyre profesional. Si shtesë ky person duhet të mbaj një regjistër të vijueshmërisë së nxënësit në praktikën profesionale (çfarë kanë bërë ata) dhe progresi i arritur në arritjen e rezultateve mësimore.

Është edhe më mirë nëse mbikëqyrësi mund të veproj si mentor i cili do ta asistoj nxënësin gjatë praktikës profesionale në kalimin e ndryshimit nga klasa në një ambient pune. Sugjerohet se mbikëqyrësi të takohet rregullisht me nxënësit për të ofruar reagime në lidhje me performancën e tyre. Gjatë këtyre takimeve, nxënësit duhet të inkurajohen që të:

- ★ Raportojnë në lidhje me përvojën e tyre të përgjithshme gjatë MVP-s apo praktikës profesionale;
- ★ Shtrojnë pyetje;
- ★ Mësojnë se si do të kontribuoj puna e tyre në organizatë;
- ★ Marrin pjesë në një vlerësim të shkathtësive dhe dobësive të tyre vetanake;
- ★ Diskutojnë fushat e nevojshme për vëmendje shtesë;
- ★ Fitojnë ndjenjën se çfarë lloj pune gjendet para tyre.

Në të njëjtën kohë mbikëqyrësi mund të luaj rolin e udhëzuesit dhe do të jetë në gjendje të përforcoj qëndrime dhe performancë pozitive dhe sqaroj se si mund të arrihen përmirësimet e performancës.

VLERËSIMI I MVP

Vlerësimi i nxënësve për MVP apo praktikë profesionale duhet të bëhet nga ana e kompanisë. Shkolla normalisht do të propozoj formën për vlerësim dhe do ta dorëzoj atë tek kompania. Kompania duhet të vlerësoj punën praktike të nxënësit bazuar në atë se çka ka arritur në punën e tyre praktike. Shkolla gjithashtu mund të kërkoj nga nxënësit një detyrë shtesë (me shkrim apo praktike) në lidhje me atë se çka është mësuar nga praktika e tyre profesionale.

Është me rëndësi që nxënësit e praktikës profesionale të marrin reagime reale në lidhje me performancën e tyre. Institucioni/biznesi duhet të jetë konkret dhe i drejtë gjatë kryerjes së vlerësimit të nxënësit.

Vlerësimi duhet të jetë sa më objektiv dhe me fokus në atë se çka kanë mësuar nxënësit nga praktika profesionale në lidhje me planin e tyre origjinal të mësimi. Prandaj është me rëndësi që personi përgjegjës për vlerësim duhet të ketë shkathtësitë e nevojshme për të bërë vlerësim të drejtë dhe të saktë dhe ti jap nxënësit një reagim të qartë dhe konstruktiv.

PËRFITIMET E SHKOLLËS

Shkollat profesionale në Kosovë aktualisht ofrojnë arsimim për rreth 43,000 nxënës (2018–2019). Megjithatë shkollat janë të kufizuara sa i përket pajisjeve të tyre profesionale, punëtorive dhe laboratorëve ku nxënësit mund të kryejnë detyra të bazuara në punë dhe të mësojnë shkathtësitë e “botës reale” që janë të nevojshme për punësim. Si shtesë, shkollat aktualisht janë të angazhuara në mënyrë primare për ofrimin e mësimi teorik.

Për këtë arsye angazhimi për involvimin e ndërmarrjeve për të ofruar MVP apo praktikë profesionale ka një rëndësi të madhe për shkollat profesionale.

Duke bashkëpunuar me shkollat profesionale në këtë mënyrë punëdhënësit mund tu ndihmojnë atyre për të:

- ★ Rritur cilësinë dhe standardet e arsimit profesional të cilin ato e ofrojnë;
- ★ Ofruar programe të fuqishme të mësimdhënies të bazuara në nevojat e tregut të punës;

- ★ Ndërtuar partneritete më të fuqishme me tregjet e tyre lokale të punës;
- ★ Siguruar që mësimdhënësit fitojnë një kuptueshmëri të teknikave dhe praktikave moderne në sektorin e tyre;
- ★ Rritur “brand-emrin” dhe reputacion e shkollave profesionale;
- ★ Tërhequr edhe me shumë nxënës në arsimin profesional.

Dhe duke pasur më shumë nxënës të diplomuar të përgatitur nga shkollat e mesme do të shpie në rritjen e numrit të punëtorëve në dispozicion për të punuar.

ROLI I SHKOLLËS

Në organizimin e përgjithshëm të praktikës profesionale shkolla luan një rol kyç. Ato do të përpiqen të inkurajojnë punëdhënësit për pjesëmarrje duke e krijuar një proces sa më të thjeshtë dhe të drejtë që të jetë e mundur.

Shkolla normalisht do të caktojë një person i cili do të jetë përgjegjës që të kushtoj një pjesë të kohës së tij/saj për të krijuar lidhje me ndërmarrjet.

Personi përgjegjës për organizimin e praktikës profesionale duhet që përveç gjërave të tjera edhe të: Identifikoj biznesin potencial i cili dëshiron të pranoj nxënës për praktikë profesionale

- ★ Bashkë me mësimdhënësit profesional të dizajnojnë orarin për praktikën e tyre;
- ★ Mbetet në kontakt direkt dhe do të jetë në dispozicion të përhershëm të bizneseve nikoqire;
- ★ Sigurohet që janë nënshkruar marrëveshje të duhura bashkëpunimi;
- ★ Sigurohet që nxënësit janë të përzgjedhur në mënyrë të drejtë për secilën mundësi praktike profesionale;
- ★ Të sigurojë veshje uniforme për nxënësit praktikant dukshëm të dallueshme nga uniformat e punonjësve të rregullt të kompanisë;
- ★ Të sigurohet që nxënësit janë të informuar në mënyrë të duhur dhe të monitorohen gjatë praktikës profesionale;

- ★ Në bashkëpunim të ngushtë me ndërmarrjen, shkolla të dizajnojë dhe sigurojë një regjistër për nxënësit praktikant për secilin nxënës në mënyrë të veçantë, përmes së cilit regjistër, mbikëqyrësit e nxënësve do të kenë mundësi që në baza ditore të vlerësojnë aspekte të ndryshme të punës së nxënësve dhe shkallën e përmirësimit të tyre. Ky regjistër i praktikës, në fund do të ndihmojë si punëdhënësin ashtu edhe shkollën për të realizuar vlerësimin final për nxënësin praktikant.
- ★ Përgatis format e vlerësimit për bizneset dhe të sigurohet se është kryer një vlerësim i përshtatshëm.
- ★ Shkolla duhet të sigurohet se arsimtarët/mësimdhënësit janë mirë të trajnuar që nxënësve tua ndërlidhin sa më qartë pjesën teorike me atë praktike që do ta kryejnë tek ndërmarrjet. Gjithashtu, përveç anës së ngritjes profesionale, mësimdhënësit e trajnuar do të jenë në gjendje t'i motivojnë nxënësit duke i stimuluar ata për nxënie të mësimëve praktike.
- ★ Në rast se në kuadër të nxënësve praktikant ka nxënës të cilët kanë aftësi të veçanta apo të kufizuara në çfarëdo lloji aspekti, shkolla është e obliguar që paraprakisht të bëjë një klasifikim të nxënësve sipas aftësive, shëndetit, gjinisë dhe nevojave tjera specifike që mund të kenë, dhe profilin e secilit nxënës t'ua dërgojë kompanisë para fillimit të punës praktike.



Përfitimet e Bizneseve në periudhë afatgjate

Në një periudhë afatgjate punëdhënësit mund të arrijnë përfitime të mëdha për bizneset e tyre duke ofruar praktikë profesionale për nxënësit e shkollave

PËRFITIMET E BIZNESEVE

Në një periudhë afatgjate punëdhënësit mund të arrijnë përfitime të mëdha për bizneset e tyre duke ofruar praktikë profesionale për nxënësit e shkollave profesionale.

Sipas shumë hulumtimeve, kompanitë të cilat punësojnë punonjës përmes programit të praktikës profesionale kanë shkallë të mbajtjes së punonjësve për periudhë mesatare 5 vjeçare pikërisht për shkak të përzgjedhjes adekuate të punonjësve.

Përfitimet të cilat mund ti fitojnë punëdhënësit duke ofruar praktikë profesionale janë të ndryshme dhe përfshijnë:

- ★ Krijimi i një grupi të rinjsh të gatshëm për tregun e punës dhe një përshtypje e mire për biznesin apo sektorin tuaj;
- ★ Potenciali për reduktimin e shpenzimeve për rekrutimin e stafit duke ju ndihmuar për të identifikuar punëtorët e rinj potencial të cilët mund të kontribuojnë për biznesin tuaj. Mundësia e rekrutimit të punonjësve të talentuar është e lartë sepse rekrutimi i punonjësve të rinj dhe të mirë është një proces që shteron burimet e kompanisë. Përveç kësaj, përmes kësaj metode rekrutimi, në mënyrë direkte do të zvogëloni pakënaqësitë e kandidatëve të tjerë dhe ankesat e tyre në proces të rekrutimit, gjë që do të ndikonte në ngritje të reputacionit të kompanisë suaj në tregun e punës;
- ★ Në shumë kompani është vërejtur rritje e ndjeshme e performancës së të gjithë punonjësve tjerë me rastin e angazhimit të nxënësve praktikant sepse punonjësit aktual tuaj do të duan të jenë shembull i mirë për ta. Studentët praktikant zakonisht kanë shumë pyetje dhe punonjësit duan të jenë të dobishëm për ta; Fakti që studentët praktikant do të mbikëqyren nga punonjësit e rregullt të ndërmarrjes suaj, do të vë në dukje aftësitë menaxhuese të tyre dhe për ju si punëdhënës është moment i rëndësishëm për identifikim të menaxherëve potencial për ndërmarrjen tuaj. Rritja e vizibilitetit të kompanisë/organizatës suaj brenda komunitetit lokal, me ç' rast edhe imazhi i kompanisë do të rritet;

- ★ Kontributi i përgjithshëm për shoqërinë duke ju ndihmuar nxënësve për të zhvilluar shprehi të mira pune dhe përmirësimin e shanseve të tyre për punësim në të ardhmen;
- ★ Sjellja e ideve të reja në biznesin tuaj dhe qasje inovative;
- ★ Fitimi i fuqisë punëtore pa shpenzime shtesë pasi që nxënësit në mënyrë të vazhdueshme bëhen më produktiv gjatë vazhdimin të praktikës së tyre profesionale;
- ★ Demonstrimi i zotimeve tuaja për “përgjegjësinë shoqërore të korporatave” të cilat mund të ju bëjnë juve një parter biznesi më atraktiv apo përfitues grantesh që ofrojnë projektet e ndryshme.

Si punëdhënës ju këshilloheni që ti informoni nxënësit se çka pritni nga ata. Kjo më së miri bëhet në ditën e parë kur nxënësit fillojnë periudhën e praktikës së tyre profesionale. Është e rëndësishme që nxënësit në ditën e parë të praktikës të informohen në lidhje me rregullat e shtëpisë dhe me gjërat e rëndësishme që ata duhet ti dinë në lidhje me organizatën tuaj.

Ju gjithashtu këshilloheni që të bashkëpunoni me shkollën për tu siguruar që edhe ata të informojnë gjithashtu nxënësit e tyre në lidhje me kërkesat specifike për vendin e tyre të punës.

ROLET E BIZNESEVE

Shkollat në përgjithësi do të përpiqen që ta bëjnë rolin e punëdhënësit sa më të thjeshtë që është e mundur dhe të kufizojnë shumën e dokumentacionit formal të përfshirë. Megjithatë ekziston një numër aspektesh të MVP-s apo praktikës profesionale të cilat kanë nevojë për përfshirjen e punëdhënësit.

Roli i kompanisë do të përfshijë:

- 01.** Diskutimi dhe nënshkrimi i disa formave të “marrëveshjeve të bashkëpunimit” me shkollën; – Në secilën marrëdhënie bashkëpunimi serioz, preferohet firmosja formale e një marrëveshjeje bashkëpunimi. Edhe në këtë rast, një marrëveshje bashkëpunimi do të draftohet nga ana e institucionit arsimor në të cilën marrëveshje do të përshkruhen qartë të gjitha detyrimet dhe obligimet që dalin nga marrëveshja.

Draft marrëveshja do tu dërgohet ndërmarrjes-ve për rishikim, komentim dhe inkoorporim të komenteve mbi ndonjë çështje të caktuar që ndërmarrja vlerëson se është e nevojshme dhe në të mirë të palëve të vendosen formalisht në marrëveshje të bashkëpunimit. Pas dakordimit të palëve me të gjitha pikat në kuadër të marrëveshjes, bëhet edhe zyrtarizmi i saj përmes firmosjes zyrtare. Sikurse shumica e modeleve të marrëveshjeve të bashkëpunimit edhe ky model nuk do të prodhojë asnjë efekt ligjor për asnjërën palë të involvuar.

Marrëveshja duhet të jetë një dokument zyrtar i cili do ta legalizon përfshirjen e nxënësit në praktikë në kompani, duhet të jenë të përfshira të gjitha obligimet e palëve.

02. Marrëveshja duhet të ketë katër akter për firmosje si: Nxënësin, Prindin, Përfaqësuesin e kompanisë dhe Përfaqësuesin e shkollës. Pajtueshmëria me shkollën se çfarë praktike profesionale do të bëjnë nxënësit dhe çka duhet të mësojnë;- Duke qenë se numri i profesioneve, drejtimeve në shkolla profesionale është relativisht i madh, shkolla profesionale do të propozojë një plan të praktikës profesionale tek ndërmarrja bazuar në pjesët teorike të ligjëruara në shkollë. Ky plan do të rishikohet nga ana e ndërmarrjes dhe mund të plotësohet dhe revidohet varësisht nga aktivitetet që ndërmarrja ka. Plani i praktikës do të përmbajë gjithashtu edhe kohëzgjatjen e pjesës praktike dhe fondin e orëve për aktivitetet e dakorduara.

03. Ofrojnë një hyrje për nxënësit që i fillojnë praktikën në kompani; – Para fillimit të pjesës praktike, secilit nxënësi në mënyrë të qartë duhet t'i sqarohen nga ana e shkollës dhe ndërmarrjes rregullat e përgjithshme të ndërmarrjes, kodi i mirësjelljes që nënkupton sjellje korrekte të nxënësve me punonjësit e ndërmarrjes pavarësisht pozicionit të tyre në ndërmarrje, sjelle korrekte me klientët e ndërmarrjes, me bashkëpunëtorët dhe të gjitha palët me të cilat biznesi bashkëpunon, kodi etik që nënkupton etikë profesionale në vendin e punës, mbrojtje të informacioneve konfidenciale të ndërmarrjes etj, kodi i veshjes etj. Nxënësit praktikant do të jenë të obliguar të respektojnë orarin e rregullt të punës së ndërmarrjes, përveç në rastet kur ndërmarrja dhe shkolla vendos ndryshe apo ka ndonjë kufizim ligjor. Preferohet që orari të jetë sa më fleksibil, me qëllim të përshtatjes së kohës edhe për nxënësit të cilët udhëtojnë në distanca më të largëta.

- 04.** Ofrojnë vend pune të sigurt dhe shëndetshëm dhe të sigurohen që nxënësve të praktikës profesionale u janë dhënë udhëzime dhe trajnime të përshtatshme për sigurinë;- Brenda mundësive të saja, ndërmarrja duhet tu ofrojë një mjedis të sigurt pune nxënësve praktikant për vetë faktin se janë të pa përvojë në menaxhim të ndonjë situatë të rrezikshme. Gjithashtu operimi me makineri, komponentë me rrezikshmëri të lartë (në rast se një gjë e tillë është paraparë në plan të praktikës) gjithnjë duhet të bëhet vetëm në mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nga punonjësi profesional i kompanisë.
- 05.** Caktojnë një person i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e nxënësit gjatë punës së tij praktike;- Me qëllim të rritjes së aftësive profesionale të nxënësve, ndërmarrja duhet të caktojë një person përgjegjës i/e cila do të jetë në gjendje tu ofrojë në vazhdimësi informacione, të trajnojë nxënësin mbi punën, proceset në kompani etj. Mbikëqyrësi duhet të organizojë takime të rregullta me nxënësin praktikant dhe ta inkurajojë në vazhdimësi atë për parashtrim të pyetjeve si dhe në raportim mbi detyrat e dhëna dhe afatet kohore;
- 06.** Caktojnë një person i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe evaluimin e nxënësit, (mund të jetë i njëjtë si (5) më lartë;- Është shumë me rëndësi që nxënësit praktikant të monitorohen dhe të vlerësohen në vazhdimësi nga personi përgjegjës. Kjo në radhë të parë do t'i krijojë atyre ndjenjën e përgjegjësisë ndaj punës dhe ndërmarrjes, do të korrigjonte me kohë gabimet eventuale. Një vlerësim i shkurtër nga mbikëqyrësi rekomandohet që t'i jepet nxënësit praktikant në fund të ditës dhe të kërkohet reflektim mbi udhëzimet e dhëna shtesë.
- 07.** Mirëmbajtja e regjistrit të nxënësit ku shënohet se çfarë kanë bërë ata gjatë Praktikës Profesionale; - Përgjatë gjithë programit të praktikës, nxënësit praktikant do të jenë të obliguar të mbajnë shënime, një regjistër, ku do të shënojnë çfarë kanë bërë gjatë praktikës. Në fund të secilës javë ky regjistër duhet kontrolluar dhe konfirmuar nga ana e mbikëqyrësit të nxënësit. Format e kompletuara për secilën javë nxënësit do të jenë të obliguar ti dorëzojnë në shkollë. Forma e regjistrit të nxënësit do të përpilohet nga ana e shkollës dhe do tu prezantohet ndërmarrjes.

08. Informimi i shkollës në lidhje me ndonjë çështje, problem apo parregullsi; – Nxënësit praktikant janë të obliguar që gjatë punës së tyre praktike të punojnë në harmoni të plotë me rregullat dhe politikat e ndërmarrjes si dhe në harmoni me ligjet e aplikueshme në Kosovë. Në rast të ndonjë çështjeje, problemi apo parregullsie në lidhje me nxënësin, rekomandohet që menjëherë ndërmarrja të njoftojë shkollën mbi çështjen e ngritur por jo më larg se 24 orë nga momenti i evidentimit të çështjes.

